



Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.



**RREGULLORE  
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E  
KONFIDENCIALITETIT NË "ALBPETROL" SH.A.**

*Patos, Dhjetor 2021*



Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

KREU I  
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në "Albpetrol" sh.a. bazohet në ligjin nr.60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm.

**Neni 2**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "I sinjalizuar" janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
2. "ILDKPKI" është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
3. "Njësia përgjegjëse" është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga dy punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
4. "Organizatë" është autoriteti publik ose subjekti privat.



Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

5. "Sinjalizim" është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.
6. "Sinjalizues" është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
7. "Subjekt privat" është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
8. "Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni" është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

#### Neni 4

#### Parimet e veprimitarisë

1. Njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. për zbatimin e ligjit nr.60/2016 "*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*", bazohet në parimin e:
  - a. ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror;
  - b. njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;
  - c. sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;
  - d. integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
  - e. zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
  - f. procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

#### Neni 5

#### Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të njësisë përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. kryhen në përputhje me ligjin nr.60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj sipas Kodit të Procedurave Administrative.



Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat njësi përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

#### Neni 6

#### Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para punonjësit të caktuar të njësisë përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.
2. Sinjalizimi përmban të paktën:
  - a. të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
  - b. të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
  - c. përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
  - d. referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
  - e. në rastin e sinjalizimit tek ILDKPKI, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga njësi përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
4. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

#### Neni 7

#### Mosfillimi i hetimit administrativ

1. Njësi përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:
  - a. sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
  - b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr.60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij;
  - c. kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes



Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

administrative ose të veprës penale.

2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar nga njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a.

### Neni 8

#### Hetimi i drejtpërdrejtë nga ILDKPKI

1. ILDKPKI-ja heton drejtpërdrejt sinjalizimin për veprimet ose praktikën e dyshuara të korrupsionit në organizata, të cilat nuk kanë një njësi përgjegjëse për këtë qëllim.
2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit tek ILDKPKI-ja në rastet kur;
  - a. njësia përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr.60/2016;
  - b. ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në njësinë përgjegjëse ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Sipas rastit, person i lidhur ka të njejtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
  - c. ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësisë përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit;
  - d. prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga organizata.
3. Në rastet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, çdo hetim i njësisë përgjegjëse, nëse ka filluar, ndërpritet dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga ILDKPKI-ja. Në rast se nuk vërtetohen kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, me vendim të arsyetuar, e dërgon sinjalizimin për nisjen ose vijimin e hetimit administrativ tek njësia përgjegjëse e organizatës.

### Neni 9

#### Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokollit dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.



Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

2. Njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

#### Neni 10

##### Parimet e hetimit administrativ

1. Në kryerjen e hetimit administrativ njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. vepron:
  - a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizuesit;
  - b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
  - c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
  - d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
  - e. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojtë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
  - f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

#### Neni 11

##### Procedura e hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.60/2016. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuar, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a.
4. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
  - a. mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
  - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit;



# Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

- c. ka të drejtë të dëgjohej në lidhje me pretendimet e tij.
5. Njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, njësia përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.
  6. Njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.
  7. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

## Neni 12

### Provat në hetimin administrativ

1. Njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të organizatave private për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Punonjësit e njësisë përgjegjëse kanë të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.
3. Në raste të veçanta, kur punonjësit e njësisë përgjegjëse vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresorë, punonjësit bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga inspektorët dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhblllokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të Administratorit të "Albpetrol" sh.a.



# Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

- Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e njësisë përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
- Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit e njësisë përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. dhe zyrtarët e organit shtetëror. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

## Neni 13

### Përfundimi i hetimit administrativ

- Njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. përfundon hetimin administrativ nëse:
  - gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, njësia përgjegjëse njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit.
  - sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.60/2016.
- Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga Administratori i kompanisë, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

## Neni 14

### Konfidencialiteti

- Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
- Njësia përgjegjëse duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.
- Njësia përgjegjëse, në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.



**Neni 15****Mbrojtja e të dhënave personale**

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr.60/2016. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektim i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**Neni 16****Afati për vendimmarrjen**

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga njësia përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a. përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
2. Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Administratorit duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.





SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

**RREGULLORE  
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT  
PËR MBROJTJEN NGA HAKMARRJA NË "ALBPETROL" SH.A.**

*Patos, Dhjetor 2021*

---

Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rruga Fier-Patos Km. 7 Patos  
T +3553813662 F +35534704415

W [www.albpetrol.al](http://www.albpetrol.al)

A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized name or set of initials.

**KREU I  
RREGULLA TË PËRGJITHSHME****Neni 1  
Baza ligjore**

Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në "Albpetrol" sh.a. Patos, bazohet në ligjin nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ILDKPKI .

**Neni 2  
Objekti**


Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

**Neni 3  
Përkufizime**

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritet publik" ka të njejtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.
2. "Hakmarrje" është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.
3. "I sinjalizuar" janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit nr.60/2016, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
4. "ILDKPKI" është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.





# Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

5. "Mbrojtje" është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të ligjit nr.60/2016.
6. "Njësia përgjegjëse" është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik, i përbërë nga dy punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.
7. "Organizatë" është autoriteti publik ose subjekti privat.
8. "Sinjalizim" është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik.
9. "Sinjalizues" është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
10. "Subjekt privat" është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
11. "Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni" është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

## KREU II

### VEPRIMET PROCEDURALE

#### Neni 4

#### Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të njësisë përgjegjëse kryhen në përputhje me ligjin nr.60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat njësia përgjegjëse cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

**Neni 5****Mbrojtja kundër hakmarrjes**

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas ligjit nr.60/2016, mbrohet ndaj çdo masë hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
  - a. shkarkimin nga puna;
  - b. pezullimin nga puna, ose të një, ose më shumë detyrave;
  - c. transferimin brenda ose jashtë organizatës;
  - d. uljen në detyrë;
  - e. uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
  - f. humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
  - g. mosngritjen në detyrë;
  - h. heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
  - i. vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
  - j. forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, paraqet kërkesë me shkrim tek Administratori i kompanisë dhe një kopje e saj i dërgohet Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.
4. Organizata merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast të mos miratimit apo moskthimit të përgjigjes brenda 5 ditësh nga data e paraqitjes së saj, ILDKPKI-ja, me kërkesë të sinjalizuesit, menjëherë i drejtohet organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin publik të marrë të gjitha masat, sipas këtij neni.
5. Nëse organi kompetent nuk merr masat e kërkuara, ILDPKI-ja i drejtohet me kërkesëpadi gjykatës kompetente.



**KREU III  
HETIMI ADMINISTRATIV****Neni 6  
Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje**

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje tek njësia përgjegjëse e organizatës.
2. Në ato organizata ku nuk ka njësi përgjegjëse sinjalizuesi që pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje i drejtohet drejtpërdrejtë ILDKPKI-së.
3. Njësia përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek ILDKPKI-ja, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.
4. ILDKPKI-ja, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e pretendimit dhe emrin e personit pranë ILDKPKI-së, i cili do të ndjekë çështjen.

**Neni 7  
Hetimi administrativ dhe barra e provës**

1. ILDKPKI-ja heton administrativisht pretendimet për hakmarrje për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur, ose pritet të ndodhë një akt hakmarrjeje.
2. ILDKPKI-ja, në hetimin administrativ, i kërkon me shkresë organizatës të provojë që masat e marra në dëm të sinjalizuesit janë bazuar në shkaqe të ndryshme dhe që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin. Organizata ka barrën e provës në këtë proces dhe i përgjigjet ILDKPKI-së me shkrim brenda 10 ditësh nga data e marrjes së kërkesës.

**Neni 8**  
**Bashkëpunimi**

1. Organizata dhe sinjalizuesi bashkëpunon me ILDKPKI-në në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes së aktit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesit. Organizata është e detyruar të paraqesë informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara ILDKPKI-së.
2. Organizata çdo deklaram apo argument të saj e paraqet me shkrim.

**Neni 9**  
**Mjetet e kërkimit të provës**

1. Gjatë hetimit administrativ ILDKPKI-ja me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen mund:
  - a. të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;
  - b. të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
  - c. të vizitojë vende të caktuara.
2. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes së aktit të hakmarrjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, ILDKPKI-ja kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).
3. ILDKPKI-ja që zhvillon procedurën administrative mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi ILDKPKI-në.

**Neni 10**  
**Njoftimi i sinjalizuesit**

1. ILDKPKI-ja njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë.





SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

2. Pavarësisht nga afatet e njoftimit, ILDKPKI-ja është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim, paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij.

#### KREU IV

#### AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT

##### Neni 11

##### Masat në përfundim të hetimit administrativ

1. Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga autoriteti publik, ILDKPKI-ja i drejtohet me shkrim organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin publik për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer. Inspektori i Përgjithshëm parashikon në shkresë edhe rekomandimin konkret për llojin e masës që duhet të merret.
2. Nëse organi kompetent nuk merr masat e kërkuara nga ILDKPKI-ja, kjo e fundit paraqet kërkesëpadi në gjykatën kompetente.

##### Neni 12

##### Afati i përfundimit të hetimit administrativ

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.





# Albpetrol

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.



## FORMULAR I SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM

### "TË NJË VEPRIMI OSE PRAKTIKE TË DYSHUAR KORRUPSIONI"

DREJTUAR: Njësia Përgjegjëse të caktuar në zbatim të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

1- Unë sinjalizuesi \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_, vendlindja \_\_\_\_\_, banues në adresën: \_\_\_\_\_ dhe me kontakte \_\_\_\_\_, me detyrën e \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_,

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

---

---

---

2- Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar shkaqet e anonimatit si më poshtë:

---

---

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

---

---

---

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

---

---

---

Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden \_\_\_\_\_

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përbën veprën penale të parashikuar nga neni \_\_\_\_\_ i Kodit Penal (nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë.)

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, në \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, punonjës i Njësia përgjegjëse në \_\_\_\_\_.

Sinjalizuesi

Emër Mbiemër

Njësia përgjegjëse

1. Emër Mbiemër

2. Emër Mbiemër

**FORMULAR KËRKESË PËR MBROJTJE NGA HAKMARRJA***(në zbatim të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit")*

1- Unë sinjalizuesi \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_, vendlindja \_\_\_\_\_, banues në adresën: \_\_\_\_\_ dhe me kontakte \_\_\_\_\_, me detyrën e \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, kam paraqitur sinjalizimin në:

a) "Albpetrol" sh.a., pranë Njesisë përgjegjëse

b) ILDKPKI  
*(Bashkëlidhur formulari i sinjalizimit të bërë)*

2- Për shkak të këtij sinjalizimi, pretendoj se jam subjekt i një akti hakmarrjeje të marrë ndaj meje si më poshtë:

Me \_\_\_\_\_ në Organizatën \_\_\_\_\_

për shkak se ndaj meje është marrë masa e \_\_\_\_\_

*(bashkëlidhur nëse keni akt shkresor për këtë gjë ose tregoni ku gjendet ai).*

Në këto kushte mbështetur në nenin 18 dhe 19 të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" paraqes kërkesën për mbrojtjen nga akti i hakmarrjes ndaj meje, pranë:

1. Njesisë përgjegjëse në \_\_\_\_\_.

2. ILDKPKI, për shkak se;

a) Nuk ka Njësi përgjegjëse në \_\_\_\_\_

b) Njesia përgjegjëse nuk ka marrë masat brenda afatit ligjor 10 ditor, nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje nga sinjalizuesi. *(Bashkëlidhur kërkesa për mbrojtje e paraqitur tek njësia përgjegjëse).*

1- Ky formular kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, u mor në dorëzim më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, punonjës i njesisë përgjegjëse në "Albpetrol" sh.a.

Sinjalizuesi

Emër Mbiemër

Njësia përgjegjëse

1-Emër Mbiemër

2-Emër Mbiemër

2- Ky formular kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja u mor në dorëzim më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, në \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, Inspektor në ILDKPKI.

Sinjalizuesi

Emër Mbiemër

Inspektor

Emër Mbiemër



SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

Regjistri i Sinqjalimit të Brendshëm në Njësitë Përgjegjëse

Nr.	Sinqjaluesi dhe funksioni	Autoritet Publike/Subjekt Privat	I Sinqjaluar dhe funksioni	Përshkrimi i objektit të sinqjalimit		Bregjitarimi i Kërkesës		Morfili i heqimi		Përfundim heqimi		Masa/Offline	Kohim Përgjigje sinqjaluesit	Ecuria	Shënime
				Nr.Data	Nr.Data	Nr.Data	Nr.Data	Nr.Data	Nr.Data						
1															
2															
3															
4															
5															
6															
7															
8															
9															
10															
11															
12															
13															
14															
15															
16															
17															
18															
19															
20															
21															
22															
23															
24															
25															
26															
27															
28															
29															
30															
31															
32															
33															
34															
35															
36															
37															
38															
39															
40															

Albpetrol Sh.A. NUIS: J829165000 / Sella Rogaia Fier-Patos Km. 7 Patos  
T: +3553813662

W: www.albpetrol.al



SHOQËRIA "ALBPETROL" S.H.A.

Regjistri i Mbrojtjes së Sinjalizuesit nga Hakmarrja

Nr.	Sinjalizuesi dhe Funkstioni	Autoriteti Publik/Subjekt Privat	I Sinjalizuar dhe Funkstioni	Përshterimi i llojit të Hakmarrjes	Regjistrimi i Kërkesës për mbrojtje Nr. Datë	Njoftimi për statusin e helimit të kërkesës Nr. Datë	Masat/Njoftimet nga Autoriteti Publik/Subjekt Privat	Kërkesë pardi drejtuar Gjykatës	Euria
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
10									
11									
12									
13									
14									
15									
16									
17									
18									
19									
20									
21									
22									
23									
24									
25									
26									
27									
28									
29									
30									
31									
32									
33									
34									
35									
36									
37									
38									
39									
40									

Albpetrol sh.a. NUIS 182916500U Selia Rrugë Fier-Patos Km. 7 Patos  
T +3553813662 F +3553470415

W www.albpetrol.al